


European Policy Institute, Skopje • Институт за европска политика - Скопје • Instituti për politikë evropiane - Shkup

REKOMANDIM NË HIJE

Analizë e Raportit të Komisionit Evropian për progresin e Republikës së Maqedonisë për vitin 2014

8 Tetor 2014



Autorë:

Dr. Malinka Ristevska-Jordanova, drejtoreshë dhe kryeredaktore e Analizës

Mr. Ardita Abazi-Imeri, koordinatorë programore për politikat sektoriale

Mr. Aleksandar Jovanoski, koordinator programor për demokraci dhe sundimin e së drejtës

Leposava Ognjanoska, bashkëpunëtore

Angel Mojsovski, bashkëpunëtor

Институт за европска политика
Дебарца 6, 1000 Скопје
П.Ф. 11, 1001 Скопје
Република Македонија

European Policy Institute
Debarca 6, 1000 Skopje
P.O. Box. 11, 1001 Skopje
Republic of Macedonia

Тел / Phone: +389(2)614513
Факс / Fax: +389(2)6145120
contact@epi.org.mk
www.epi.org.mk

Përmbajtja

Rekomandim me hap prapa	4
Vlerësime kryesore	6
Kritere politike	6
Kritere ekonomike	8
Aftësia e ndërmarrjes së detyrimeve nga anëtarësimi	10
A filloi të luajë shkopi?	10
Shtojca	12
Pasqyra e konkluzioneve dhe vlerësimeve lidhur me kriteret politike 2011-2014	12
Pasqyra e konkluzioneve dhe vlerësimeve lidhur me përmbushjen e detyrimeve nga anëtarësimi 2009-2014	26

Rekomandim me hap prapa

Konkluzionet e Raportit të këtij viti të Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë përmbajnë kritika më të ashpra deri më tani, që nga fillimi i publikimit të raporteve të këtilla në Procesin e Stabilizim Asocimit (viti 2003).

Rekomandimi mbetet, por hijet që qëndrojnë pezull mbi të janë shumë të errëta.

Bëhet fjalë për ngecje të procesit eurointegruës dhe për një kthim prapa evident të Republikës së Maqedonisë.

“Marrë në përgjithësi, duke e pasur parasysh progresin kumulativ, të cilin e ka arritur shteti, Komisioni konsideron se kriteret politike edhe më tej janë përmbushur në masë të mjaftueshme dhe e mban rekomandimin e vet për fillimin e negociatave për anëtarësim, por i vjen keq për regresin e shënuar në vitin e kaluar.”

Nëse vitin e kaluar theksi u vu mbi çështjen e emrit, këtë vit fokusi vihet mbi politikën e brendshme, ndërsa në plan të parë është kthimi prapa në kriteret politike.

Hija më e madhe e Raportit të këtij viti është vlerësimi se sfidat më serioze jo vetëm që nuk janë zgjidhur por edhe janë rritur – veçanërisht në aspektin e **“kulturës politike të përçarjes gjithnjë e më të madhe, politizimit në rritje dhe kontrollit të Qeverisë mbi institucionet shtetërore dhe mediat, si dhe gjendjes akoma të brishtë inter-etnike.**

Rekomandimi mbetet për shkak të “punës së kaluar” kumulative dhe jo për shkak të progresit të shënuar gjatë vitit të fundit. Është e qartë se Komisioni Evropian dëshiron t’i jap Maqedonisë edhe një mundësi. Në të vërtetë, Komisari në largim, Shtefan Fyle, në masë të konsiderueshme u angazhua me dosjen Maqedoni – edhe përmes dialogut aderues edhe përmes përpjekjeve që t’i jetësojë negociatat për çështjen e emrit me Greqinë. Mbase do të ishte e tepërt që, mossa e suksesit evident, në të dyja fushat, të përfundojë me revokimin e rekomandimit. U dha edhe një shans.

Komisioni e mbështet ruajtjen e rekomandimit me “progresin kumulativ”, përkatësisht faktin që “shteti e ka zbatuar pjesën më të madhe të reformave sa i përket sistemit gjyqësor dhe administratës publike”, pasi u bë kandidat për anëtarësim në vitin 2005, si dhe ka arritur nivel të lartë të harmonizimit të legjislacionit me *acquis* në lidhje me statusin në procesin aderues. Megjithatë, shtrohet pyetja, cili është rezultati i këtyre reformave gjithëpërfshirëse, të cilat Komisioni Evropian i mbështet dhe monitoron në vazhdimësi, nëse Raporti i këtij viti, me tone tejet kritike, i vlerëson të dyja fushat dhe konstaton politizim të administratës publike, si dhe mungesë të pavarësisë së gjyqësorit?

“Procesi aderues i RM-së në BE është në qorrrokak. Mosveprimi ndaj Rekomandimit të KE nënkupton se negociatat akoma nuk janë hapur. Njëkohësisht, mossa e suksesit i Qeverisë, që të arrijë rezultate të mjaftueshme për çështje kyç, i shkaktoi dëm qëndrueshmërisë së reformave, përmes regresit evident në fusha të caktuara.”

Kjo kontradiktë, në rastin Maqedoni, tregon se modeli aktual i Komisionit Evropian të monitorimit dhe stimulimit të reformave lidhur me kriteret politike ka mangësi serioze.

Në konkluzionet, Komisioni fokusohet në katër pika kritike: politizimi i institucioneve shtetërore, kontrolli i Qeverisë mbi mediat, marrëdhëniet ndër-etnike dhe kontesti i pazgjdhur me emrin.

Sipas Strategjisë për Zgjerim të këtij viti, progresi në procesin e anëtarësimit do të vlerësohet nga Komisioni Evropian në bazë të tri shtyllave: krijimi i dosjes së suksesit në përmbushjen e kriterëve dhe në zbatimin e të drejtës nga Kapitulli 23 – Jurisprudenca dhe të Drejtat Themelore dhe Kapitulli 24 – Drejtësi, Liri dhe Siguri; Qeverisja Ekonomike dhe Disiplina Fiskale dhe Reforma e Administratës Publike. Por, se si do të zhvillohen më tutje instrumentet e procesit mbetet për t’u parë. Si do që të jetë, **është e pëlqyeshme që fokusi i harmonizimit formal të riorientohet kah**

respektimi esencial i standardeve demokratike dhe rezultateve të dukshme nga reformat.

Së këtejmi, për Republikën e Maqedonisë mesazhi është i qartë – ky është rekomandimi i fundit, nëse autoritetet nuk ndërmarrin hapa vendimtarë që t’i qasen zgjidhjes së “politizimit të rritur dhe mangësive gjithnjë e më të mëdha lidhur me pavarësinë e gjyqësorit dhe lirinë e shprehjes”.¹ Këto fusha imponohen si kriterë për ruajtjen e rekomandimit.

Vërehet kthim prapa në proceset reformiste kryesore, veçanërisht në lirinë e të shprehurit dhe kontrollin e mediave, pavarësinë e sistemit të jurisprudencës dhe jokonsekuencat në sistemin e respektimit të të drejtave themelore. Të gjitha këto çështje janë pjesë të Kapitullit 23 – Jurisprudenca dhe të Drejtat Themelore dhe paraqesin bazë për fillimin e negociatave. Mbetet çështje fundamentale nëse edhe gjatë përcaktimit të datës për negociatën vendi ka kapacitet reformist për përmbushjen e kriterëve themelore (benchmarks) për hapjen e këtij Kapitulli.

Kriteret për ruajtjen e rekomandimit:

- Depolitizimi;
- Pavarësia, kompetenca dhe cilësia e gjyqësorit;
- Liria e shprehjes.

Në konton pozitive vendoset “progres i caktuar i mëtutjeshëm” në “reformat e administratës publike” dhe “bashkëpunimi aktiv policor rajonal dhe ndërkombëtar”. Megjithatë, edhe një hije qëndron pezull mbi këtë vlerësim pozitiv – vërejtja se **“krimi i organizuar dhe korrupsioni janë thelbësor për luftën kundër infiltrimit të sistemit politik, juridik dhe ekonomik”.**

¹ Enlargement Strategy and Main Challenges 2014-2015, Communication from the Commission to the European Parliament, Council, the European Economic and Social Committee and Committee of the Regions, p.23

Në këtë pako dokumentesh për zgjerim, Komisioni nuk e thekson qëndrimin për nevojën e zgjidhjes së çështjes së emrit në fazën e hershme të negociatave, për dallim nga viti i kaluar, mbase duke e perceptuar pamundësinë që një propozim i këtillë të kalojë në Këshillin e BE-së. Përsëritet rëndësia e gjetjes së zgjidhjes së kontestit me Greqinë dhe zhvillimit të marrëdhënieve të mira fqinjësore me Bullgarinë. Fitohet përshtypja se Komisioni e pranon se është i pafuqishëm që edhe më tej të kontribuojë në zgjidhjen e kontestit për emrin, kështu që i thërret “liderët e BE-së të japin mbështetje proaktive”.

Fitohet përshtypja se Komisioni e pranon se është i pafuqishëm që edhe më tej të kontribuojë në zgjidhjen e kontestit për emrin, kështu që i thërret “liderët e BE-së të japin mbështetje proaktive”.

Vlerësime kryesore

Kriteret politike

Komisioni në konkluzionet e veta edhe këtë vit, në të gjitha fushat në kuadër të kriterëve politike, nuk i përdor termet e standardizuara (progres i vogël, progres mesatar, progres, etj.), por vlerësimet i bënë me përshkrim. Në mënyrë të detajuar dhe faktografike përshkruhen gjendjet. Analiza e EPI-it, në krahasim me vlerësimet e kriterëve politike, të vitit 2013, vëren një gjuhë më të ashpër dhe më kritike në Raportin për vitin 2014, veçanërisht sa i përket lirisë së shprehjes dhe mediave dhe pavarësisë së sistemit të jurisprudencës. Përdoren termet, si: shqetësim i madh, kthim prapa (back-sliding) në Kapitullin 23 – Jurisprudenca dhe të Drejtat Themelore, kontrolli i autoriteteve, shkrirja midis shtetit dhe partive në pushtet, si dhe kontrolli i autoriteteve mbi procese të caktuara gjyqësore.

- Kriza politike midis Qeverisë dhe partive opozitare, sipas Komisionit, vë në pah se “interesat partiak gjithnjë e më shumë dominojnë mbi interesat nacional”. Sigurisht se as Qeveria e as opozita nuk do të jenë krejtësisht të kënaqura me formulimet e Raportit, sa i përket krizës rrjedhëse parlamentare, meqë përgjegjësinë ia përshkruan edhe Qeverisë edhe opozitës: “është përgjegjësi edhe e Qeverisë edhe e opozitës që të sigurojnë debat politik, i njëjti të zhvillohet në Parlament, si dhe të sigurojnë kushte për funksionim përkatës të tij”. Megjithatë, Qeverisë i takon përgjegjësia “të krijojë mundësi në mënyrë që opozita të ushtrojë kontroll demokratik mbi pushtetin”, ndërsa opozita “të inkuadrohet në mënyrë konstruktive në proceset demokratike”.² *Duke i marrë parasysh vlerësimet kryesore, Raporti në të vërtetë i legjitimoi shkaqet e bojkotit të opozitës, por jo edhe vet bojkotin.*
- Sa u përket ndryshimeve kushtetuese Raporti është i përmbajtur, por sugjerohet se çdo ndryshim i Kushtetutës doemos duhet të mbështetet mbi një konsensus të gjerë. Konstatohet edhe shqetësimi sa u përket ndryshimeve të Gjykatës Kushtetuese të cilat viteve të fundit kanë ndikuar mbi pavarësinë e saj dhe se “ka filluar të vonohet dhe të bëjë kompromise gjatë marrjes së vendimeve”.
- Vlerësimi lidhur me zgjedhjet e administruara mirë është nën hijen e mungesës së kushteve të barabarta për shkak të mosdistancimit të partisë nga shteti, presioneve mbi votuesit dhe raportimit joobjektiv mediatik.

² Commission Staff Working Document for the Republic of Macedonia Progress Report, Communication from the Commission to the European Parliament, Council, the European Economic and Social Committee and Committee of the Regions, p.7-8

- Qeverisë i rekomandohet të punojë “në mënyrë më të integruar, të koordinuar dhe transparente lidhur me çështjet nacionale, çështjet në lidhje me marrëdhëniet midis bashkësive dhe çështjet që kanë të bëjnë me BE”. Ky rekomandim vë në pah se mënyra aktuale e punës, sa u përket këtyre çështjeve kryesore, konsiderohet e pa-integruar dhe e pa-koordinuar. Pastaj, nga Qeveria kërkohet “të ndërmerr aktivitete për distancimin e shtetit nga partitë në pushtet”, si dhe të përfundojë procesi i decentralizimit dhe të mbështetet zhvillimi lokal.
- Kundrejt progresit të legjislacionit, **administrata publike** karakterizohet si: “**e fragmentarizuar dhe objekt i impaktit politik**”.
- Në Raport theksohet se *shoqëria e lirë dhe e përforcuar civile* ka rol kritik në çdo sistem demokratik dhe roli i saj duhet të njihet dhe trajtohet në këtë mënyrë nga ana e Qeverisë. Konstatohet roli pozitiv i një pjese të sektorit civil, në drejtim të avancimit të bashkëpunimit strukturor me Sekretariatit për Çështje Evropiane lidhur me IPA 2, ku merr pjesë edhe Instituti për Çështje Evropiane bashkë me gjashtë organizata partnere.
- Gjqësori është një fushë kritike në Raportin e këtij viti. Kundrejt reformave të zbatuara juridike dhe institucionale, në përputhje me standardet evropiane dhe efikasitetin e rritur, vihet në pikëpyetje pavarësia dhe cilësia e vendimeve gjyqësore, ndërsa flitet edhe për “drejtësi selektive”. Komisioni nuk ndërhyr në lëndë të veçanta gjyqësore.
- Përveç vlerësimit pozitiv lidhur me kornizën e krijuar ligjore dhe institucionale dhe dosjes së lëndëve të antikorrupsionit, vihet në pah rreziku për kthimin prapa në këtë fushë, duke i theksuar fushat në të cilat duhet të përkushtohet vëmendja: prokurimet publike, korrupsioni politik dhe korrupsioni në nivele të larta.
- Korniza e të drejtave themelore është vendosur, megjithatë fokusi duhet të përqendrohet në implementimin efektiv të saj. Situata, sa i përket lirisë së shprehjes vlerësohet si “shumë problematike” dhe se përkeqësohet edhe më tutje. Kualifikimet vazhdojnë me: “ndikimin e Qeverisë përmes reklamave të financuara nga shteti”, “raportimet e pavarura janë të rralla, mungojnë informata të sakta dhe objektive nga ana e mediave më të mëdha”, “mungon debati publik informativ”. Së këtejmi, mund të nënkuptohet se pse kjo fushë është vendosur si kriter për ruajtjen e rekomandimit.
 - Është interesante e dhëna e prezantuar – se aktgjykimet gjyqësore për shpifje “janë në numër relativisht të vogël dhe konservative sa i përket përcaktimit të dëmshpërblimit”, megjithatë, ka edhe përjashtime që kanë të bëjnë me “persona publike”, gjë që dërgon “mesazh të dëmshëm” për lirinë e shprehjes. Qeverisë dhe gazetarëve u sugjerohet t’i praktikojnë mjetet jashtë-gjyqësore për zgjidhjen e lëndëve të këtilla, ndërsa gazetarët dhe “personat publike” të japin shembull personal. Edhe pse nuk përmenden emra, lehtësisht identifikohen eshalonët më të lartë të pushtetit.

Komisioni i rekomandon Qeverisë të punojë: “në mënyrë më të integruar, të koordinuar dhe transparente lidhur me çështjet nacionale, çështjet në lidhje me marrëdhëniet midis bashkësive dhe çështjet që kanë të bëjnë me BE”.

- Sa u përket të drejtave të personave LGBTI, mungesa e akteve të reja të dhunës nuk e arsyeton mosnivicimin e procedurës kundër personave përgjegjës për incidentet e vitit të kaluar. Përsëritet konstatimi se Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi nuk është harmonizuar me *acquis*.
- Gjendja e bashkësisë rome është vlerësuar si jashtëzakonisht kritike – varfëri e thellë dhe kushte të këqija sociale dhe ekonomike, edhe përkundër Strategjisë së miratuar dhe mbështetjes, kryesisht me mjete nga jashtë.
- Raporti e vë në pah hapësirën e mundshme për avancimin e zbatimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit – mosdiskriminimi, përfaqësimi i drejtë, përdorimi i gjuhëve dhe arsimit. Kritikohet punësimi i bashkësive joshumicë pa vende pune të caktuara dhe shpeshherë “pa respektimin e principit të meritës”. Nga rastet kritike Raporti i thekson protestat e lëndës “Monstra”, si dhe rastin e vrasjes në Gjorçe Petrov. Edhe pse janë vlerësuar pozitivisht përpjekjet e përbashkëta të partnerëve të koalicionit për qetësimin e protestave, kërkohet më shumë angazhim për avancimin proaktiv të marrëdhënieve midis bashkësive.
 - Marrëdhëniet midis bashkësive janë një nga fushat kryesore të cilat theksohen në Konkluzionet për Republikën e Maqedonisë. Konstatohet se “dominon mungesa e besimit midis bashkësive”, si dhe se “ngjarjet dhe incidentet lehtësisht shkaktajnë tensione”. Qeverisë i rekomandohet një qasje proaktive dhe e përbashkët në ndërtimin e shoqërisë inkluzive multietnike. Sugjerohet nevoja që të kompletohet analiza e Marrëveshjes Kornizë dhe të jepen rekomandime.
- Vlerësimi, sa u përket marrëdhënieve të mira fqinjësore, kësaj radhe, është diversifikuar – përkundër konstatimit të “marrëdhënieve të mira me shtetet e tjera në procesin e aderimit dhe rolit aktiv në rajon”, theksohet rëndësia e “qasjes konstruktive me shtetet-anëtare fqinje”, duke iu shmangur vlerësimit të anëtarësimit. Përsëritet rekomandimi që të shmangen aktivitetet dhe deklaratat të cilat ndikojnë negativisht mbi marrëdhëniet e mira fqinjësore.

Marrëdhëniet ndëretnike janë në qendër të vëmendjes. Me qëllim të tejkalimit të besimit të pamjaftueshëm midis bashkësive, nevojitet “qasje proaktive dhe e përbashkët e Qeverisë”.

Pasqyra e vlerësimeve kryesore, krahasuar me periudhën kohore 2011-2014 është dhënë në Shtojcën 1 .

Kriteret ekonomike

Mbetet vlerësimi nga viti i kaluar se Maqedonia shënon progres të madh në kriteret ekonomike, si dhe se ka arritur progres të mëtutjeshëm, por jo edhe se i përmbush të njëjtat.

Krahas progresit të konstatuar, sa i përket rimëkëmbjes ekonomike, Komisioni vë në pah “rigjeditetin strukturor” dhe faktin se **“politika ekonomike dhe menaxhimi me financat publike udhëhiqen nga motivet *ad hoc*, në vend që të udhëhiqen nga nevojat afatgjate të ekonomisë”.**

Komisioni Evropian paralajmëron se rritja e prodhimtarisë duhet të ketë bazë më të gjerë dhe se deficitin i jashtëm mund t'i nënshtrohet rritjes.

Në këtë vit Raporti potencon “dikotominë në mjetet kapitale, me ç’rast investimet e huaja përqendrohen në sektorët me intensitet të lartë të produktivitetit teknologjik, ndërsa kapitali i ekonomisë lokale mbetet i ulët dhe i vjetruar”.

Konstatohet investimi në disiplinën fiskale, si dhe transparenca dhe cilësia e konsumit qeveritar në vitin 2013 dhe 2014. Edhe këtë vit sugjerohet se cilësia e konsumit publik duhet të përmirësohet, përmes ndryshimit të përbërjes së shpenzimeve kapitale në drejtim të rritjes së investimeve.

Rimëkëmbja ekonomike ka ndikim të kufizuar mbi papunësinë, e cila edhe më tutje mbetet në nivel të lartë, veçanërisht tek popullata e re.

Komisioni e kritikon rritjen e vazhdueshme të niveleve të borxhit qeveritar dhe publik, dhe shpreh shqetësim sa i përket qëndrueshmërisë afatgjate të borxhit.

Në Raport konstatohet se sistemi juridik i ekonomisë së tregut në masë të madhe është i vendosur, por e përsëritë vlerësimin për mosefikasitetin në praktikë dhe në zbatimin e së drejtës, si dhe të pasigurisë juridike, të cilën e shkaktojnë ndryshimet e shpeshta të ligjeve.

Vlerësimi është pozitiv, sa i përket stabilitetit të sistemit financiar dhe përforcimit të funksionit mbikëqyrës, megjithatë sugjerohet nevoja për përmirësimin e qasjes të sektorit privat deri te mjetet.

Këtë vit Raporti e potencoi “dikotominë e mjeteve kapitale, me ç’rast investimet e huaja përqendrohen në sektorë me intensitet të lartë të produktivitetit teknologjik, ndërsa kapitali i ekonomisë lokale mbetet i ulët dhe i vjetruar”. Hapet çështja e vlerës së shtuar nga investimet e huaja – në ç’masë ato realisht mund të vendosin zinxhirë prodhues me ekonominë lokale dhe të kontribuojnë në drejtim të një ndërhyrjeje më serioze të ristrukturimit të ekonomisë maqedonase.

Mbetet e hapur çështja se pse Republikës së Maqedonisë edhe më tutje nuk i jepet statusi i ekonomisë funksionale të tregut, edhe krahas progresit të konstatuar për çdo vit – Komisioni, a bën vlerësim real se mangësitë e detektuarra e pamundësojnë një gjë të këtillë ose në plan të parë është pamundësia që të arrihet marrëveshje politike rreth këtij vlerësimi.

Është i ri edhe vlerësimi sa i përket ndikimit të shtuar të shtetit mbi konkurrencën e tregut maqedonas përmes “instrumenteve të tjera të politikës” edhe përkrah pjesëmarrjes së ulët të shtetit në kapital, legjislacionit të avancuar lidhur me ndihmën e shtetit dhe derregullimit të tregut të energjisë elektrike. Në mënyrë konkrete janë theksuar instrumentet, si vijojnë: subvencionet e drejtpërdrejta dhe lirimet nga tatimet, veçanërisht për investitorët e huaj; inspeksionet dhe dënimet për firmat; riprogramimi i pagesave të kontraktuara; garancitë publike për huamarrjet e ndërmarrjeve publike; projektet e infrastrukturës publike dhe programet aktive të tregut të punës.

Mbetet e hapur çështja se pse Republikës së Maqedonisë edhe më tutje nuk i jepet statusi i ekonomisë funksionale të tregut, edhe krahas progresit të

konstatuar për çdo vit – Komisioni, a bën vlerësim real se mangësitë e detektuarat e pamundësojnë një gjë të këtillë ose në plan të parë është pamundësia që të arrihet marrëveshje politike rreth këtij vlerësimi. Kjo është sidomos e rëndësishme duke e pasur parasysh atë se shtylla e dytë e Strategjisë së Zgjerimit është qeverisja ekonomike.

Aftësia e ndërmarrjes së detyrimeve nga anëtarësimi

Përsëritet vlerësimi nga viti i kaluar se **shteti tanimë ka arritur nivel të lartë të harmonizimit, duke e pasur parasysh fazën e anëtarësimit në të cilën gjendet.**

KE përsëri është e përmbajtur sa i përket avancimit të vlerësimit për nivelin e harmonizimit me *acquis*.

Komisioni Evropian në Strategjinë e Zgjerimit me **nivel të avancuar të harmonizimit** e thekson Të drejtën e shoqërive tregtare, Shërbimet postare në Kapitullin që ka të bëjë me Lirinë e Themelimit dhe Shërbimet dhe Lirinë e Qarkullimit të Kapitalit. Analiza jonë tregon se përveç këtyre kapitujve të theksuar në mënyrë specifike, **progres të kënaqshëm/të mirë** ka edhe në kapitujt: Politika e Konkurrencës; Shoqëria Informatike dhe Mediat; Shkenca dhe Hulumtimi; Statistika; ndërkaq **progres të mëtutjeshëm** kanë kapitujt: Unioni Doganor, Drejtësia, Liria dhe Siguria dhe Siguria e Ushqimit, Politika e Veterinarisë dhe Fitosanitare. Sa i përket fushës së Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme theksohet progres në fushën e politikës së vizave, kufijtë e jashtëm dhe Shengen, si dhe bashkëpunimi policor.

Në kontinuitet kemi progres të keq në Kapitullin 19. Politika Sociale dhe Punësimi, 22. Politika Rajonale dhe Instrumentet Strukturore, 23. Jurisprudenca dhe të Drejtat Themelore, 27. Mjedisi Jetësor dhe 32. Kontrolli Financiar – kapituj jashtëzakonisht të rëndësishëm për shfrytëzimin e fondeve të BE-së.

(Shtojca 2. – Pasqyra e vlerësimeve lidhur me progresin dhe nivelin e harmonizimit me *acquis* viti 2009-2014)

A filloi të luajë shkopi?

Pas analizës së detajuar mbi Raportin dhe konkluzioni i pamohueshëm se ai është shumë më kritik, në krahasim me Raportin e vitit të kaluar, shtrohet pyetja: a fillon të luajë shkopi? Me paralajmërimin e qartë se rekomandimi nuk do ruhet nëse nuk ka progres në fushat kryesore (depolitizimi, pavarësia e jurisprudencës, liria e shprehjes), jepet mesazhi se nuk do të ketë më tolerancë për regres në thelbin e kritereve politike.

Në mungesë të “karotës”, përkatësisht mosekzistimit të perspektivës për hapjen e negociatave të cilat do të shpinin në anëtarësim, mbetet të shihet efektiviteti i këtij paralajmërimi.

Kandidati për komisar të rinj për politika fqinjësore dhe negociata aderuese, Johanes Han, në seancën dëgjimore në Parlamentin Evropian, paralajmëroi një qasje pa kompromis të politikës së zgjerimit në drejtim të demokracisë funksionale dhe sundimit të së drejtës. Nga ana tjetër, e theksoi paqëndrueshmërinë e mosrealizimit të rekomandimit të Republikës së Maqedonisë dhe rëndësinë e zgjidhjes së kontestit me Greqinë. Një pikëpyetje e madhe është se a do të jetë më i suksesshëm në krahasim me pararendësin e tij në dosjen Maqedoni. Megjithatë, ai nuk e posedon shkopin magjik.

Sidoqoftë, tani topi ndodhet në terrenin vendor, maqedonas – para së gjithash – tek Qeveria dhe, pastaj tek subjektet e tjera politike dhe tek faktorët e tjerë. Nëse Qeveria nuk i

kupton seriozisht mesazhet, e rrezikon jo vetëm shuarjen e perspektivave të Republikës së Maqedonisë për anëtarësim në BE por edhe hyrjen në një izolim më të thellë ndërkombëtar.

Shtojca

Shtojca 1

Pasqyra e konkluzioneve dhe vlerësimeve lidhur me kriteret politike 2011-2014

Kriteri/ Nënkriteri/ Kapitulli	2011	2012	2013	2014
I.1.1. Demokracia dhe sundimi i së drejtës				
Kushtetuta			<p>Kushtetuta:</p> <ul style="list-style-type: none"> – nevojitet avancim cilësor i legjislacionit; – të dhënat e Komisionit të Venecias për Lustrim: aplikim i masave të lustrimit për një kohë të gjatë pas fillimit të demokratizimit, keqpërdorim i shkaqeve politike, ideologjike dhe partiake për masat e lustrimit 	<p>Amendamentet kushtetuese ishin pa legjislacion shoqëruar për implementimin e tyre. Duhet të bazohen mbi konsensus të gjerë. BE bën analiza plotësuese të harmonizimit të legjislacionit me atë të BE. Kohëve të fundit është vënë në pikëpyetje pavarësia e Gjykatës Kushtetuese.</p>
Zgjedhjet	<p>Progres në zbatimin e zgjedhjeve. Zgjedhjet ishin kompetitive, transparente dhe mirë të administruara në mbarë vendin.</p>	<p>3</p> <p>Legjislacioni është dërguar për shqyrtim në Kuvend</p>	<p>3</p> <p>Sipas OSBE-së zgjedhjet lokale u administruan në mënyrë efikase, por me tendencë të frikësimit të votuesve dhe keqpërdorimit të mjeteve shtetërore në fushatë. Vazhdon puna e grupeve të punës për rekomandimet e mbetura të OSBE-së për legjislacionin zgjedhor dhe Listën e Zgjedhësve.</p>	<p>Sipas OSBE/ODIHR-së, zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare u administruan mirë, pa u penguar e drejta e tubimit. Vërehet distancimi i paqartë midis shtetit dhe partisë. Sugjerohet mjedisi i pabarabartë për garë politike ndërmjet kandidatëve politikë. Përsëritet shqetësimi për frikësimin e votuesve. Kritika mbi mediat dhe mënyrës së raportimit dhe mospasje e</p>

Kriteri/ Nënkriteri/ Kapitulli	2011	2012	2013	2014
				dallimit të qartë midis aktiviteteve të përfaqësuesve të pushtetit dhe kandidatëve politikë në zgjedhje. KSHZ-ja është vlerësuar mirë për administrimin e zgjedhjeve. Dy grupet e punës gjatë verës vazhduan me punë për adresimin e rekomandimeve nga OSBE/ODIHR.
Dialogu politik	Progres i caktuar	2 ³	4	Përgjegjësia bie mbi Qeverinë dhe opozitën sa i përket sigurimit të debatit politik në Kuvend dhe sigurimit të kushteve për funksionimin e tyre.
Parlamenti	Progres i caktuar	2 Është ruajtur funksionimi i Kuvendit dhe dialogut politik; mbështetje e fuqishme e DANL	3 Parlamenti u godit nga kriza e 24 dhjetorit dhe bojkoti i bllokut opozitar. Me rëndësi të jashtëzakonshme është të vazhdohet me punën e implementimit të rekomandimeve të kontraktuara. Duhet të përmirësohet dialogu midis partive politike në Kuvend.	Funksionimi i Kuvendit u pengua nga mungesa e dialogut konstruktiv politik dhe ndarjes së thellë midis partive politike. Ekziston nevoja për vendosjen e kontrollit dhe balancimit mbi aktivitetet e Qeverisë nga ana e opozitës.
Pushteti ekzekutiv	Dallime të tejkaluara, bashkëpunim i përforcuar	3 Bashkëpunimi në koalicion ka vazhduar dhe ka arritur në vendosjen e procesit të aderimit në qendër të agjendës politike. Maturi në ballafaqimin me tensionet	3 Qeveria ishte stabile dhe vazhdoi me përkushtimin e saj ndaj reformave që kanë të bëjnë me BE, të cilat mbeten lartë në agjendën e saj. Nevojitet qasje më e fuqishme e bazuar mbi konsensusin në politikë si dhe distancomi i partive politike dhe strukturave shtetërore.	Qeveria e Maqedonisë duhet të funksionojë më mirë si njësi, me qëllim të ndërmarrjes së masave proaktive dhe të përbashkëta për përforcimin e besimit ndërmjet bashkësive në vend. Nënkryetari i Qeverisë për BE vazhdon të ketë rol kryesor në koordinimin e procesit të BE-së.. Regjistrat administrativ, si zëvendësim të Regjistrimit të pasuksesshëm dhe metodologjia për zbatimin e tyre duhet të zbatohen me konsensus të gjerë

³Nuk është veçuar në këtë pjesë të këtij Raporti , dialogu politik trajtohet në kuadër të Kuvendit.

⁴Nuk është veçuar në këtë pjesë të këtij Raporti , dialogu politik trajtohet në kuadër të Kuvendit.

Kriteri/ Nënkriteri/ Kapitulli	2011	2012	2013	2014	
		ndëretnike		politik. Qeveria e koalicionit duhet të aplikojë qasje të integruar, të koordinuar dhe transparente me qëllim të zbatimit të masave proaktive për çështje nacionale, ndëretnike dhe çështje të BE-së. Duhet të ndërmerren aktivitete për adresimin e rekomandimeve nga OSBE/ODIHR për shkrirjen e shtetit me partitë në pushtet.	
Shoqëria civile				Shoqëria civile e përforcuar është komponentë kritike për çdo sistem demokratik dhe roli i saj duhet të njihet dhe trajtohet në këtë mënyrë nga ana e pushtetit. Edhe krahas përmirësimeve formale në procesin e konsultimit, organizatat civile shprehin shqetësim për klimën e vështirë në të cilën funksionojnë.	
Administrata publike	Progres në kornizë, progres i kufizuar në implementim	2	Progres i caktuar	2	Vazhdoi puna e kornizës së re ligjvënëse për unifikimin e rregullave dhe inkorporimin e principeve të transparencës dhe meritës. Nevojiten përpjekje shtesë për avancimin e profesionalizmit dhe pavarësisë së administratës publike, si dhe përfaqësimin e drejtë. Administrata publike është fragmentizuar dhe është objekt i ndikimit politik edhe përkundër progresit të rregullimit normativ të fushës. Duhet të bëhen përpjekje plotësuese për sigurimin e principit të transparencës dhe përgjegjësisë, meritës dhe përfaqësimit të drejtë. Transparenca fiskale duhet të avancohet.
Jurisprudenca	Progres i kufizuar	1	Përgjithësisht, progres i caktuar; progres në efikasitetin e	2	KAPITULLI 23 Progres i caktuar, nevojiten përpjekje plotësuese për sigurimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe të adresohet problemi i

Kriteri/ Nënkriteri/ Kapitulli	2011	2012	2013	2014
		sistemit gjyqësor, i kufizuar në pavarësi dhe cilësi	procedurave të gjata gjyqësore.	administrative. Megjithatë, ekziston rreziku i kthimit prapa në fushën e jurisprudencës. Ekziston pavarësi strukturore kundrejt pavarësisë funksionale të gjyqtarëve. Duhet të avancohet cilësia e drejtësisë dhe standardet për dhënien e shërbimeve qytetarëve. Njëra nga sfidat kryesore është rritja e shqetësimit lidhur me selektivitetin e gjyqësorin dhe ndikimin mbi gjyqësorin dhe organet me autorizime të veçanta. Prezumimi i pafajësisë nuk është kuptuar dhe respektuar plotësisht nga ana e autoriteteve. Ekzistojnë dyshime brenda dhe jashtë shtetit për ndikim të mundshëm politik mbi procese të caktuara gjyqësore.
Lufta kundër korrupsionit	Progres i kufizuar	1 Progres i vogël evident	1 KAPITULLI 23 Korniza ligjvënëse është kompletuar dhe nevojiten angazhime për sigurimin dhe përmirësimin e efikasitetit të gjykatave në raport me monitorimin e rasteve të paraqitura pranë prokurorisë publike, në lidhje me sanksionimin dhe shpejtësinë e procedurave.	KAPITULLI 23 Ekziston rreziku nga kthimi prapa në fushën e luftës kundër korrupsionit. Korniza ligjore dhe institucionale e vendit gradualisht kalon në dosje të suksesit, sidomos në zbatimin e hetimeve, prokurori dhe aktgjykimet. Sugjerohet në nivelin e pakënaqshëm të planifikimit strategjik dhe përmbushjes së fushave kryesore – prokurime publike, korrupsion politik dhe korrupsion në nivel të lartë. Përkushtimi i rritur politik është me rëndësi jashtëzakonisht të madhe.

Kriteri/ Nënkriteri/ Kapitulli	2011	2012	2013	2014
				Zbatim selektiv i kornizës ligjore dhe ndikim politik mbi proceset. Besimi publik në organet, të cilat zbatojnë politika për luftë kundër korrupsionit, akoma është në nivel të ulët. Korrupsioni vazhdon të jetë i pranishëm në shumë fusha dhe vazhdon të jetë problem serioz.
Respektim i të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut	Ekziston kornizë ligjore, kornizë jo e plotë institucionale; progres i kufizuar në avancimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut	1 Progres i kufizuar në avancimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut	1 KAPITULLI 23 Progres i mëtutjeshëm me ratifikimin e Konventës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Abuzimi Seksual dhe Protokollit të Tretë Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.	KAPITULLI 23 Është realizuar progres i mëtutjeshëm.
Të drejta civile dhe politike me theks mbi lirinë e shprehjes dhe mediat e pavarura	Progres i kufizuar	1 Progres i caktuar i mëtutjeshëm	2 5	Ekziston korniza juridike për mbrojtjen e të drejtave fundamentale, por nevojitet fokusimi mbi implementimin efektiv. Situata sa i përket lirisë së shprehjes edhe më tej është skajshëm problematike, edhe përkrah inkuorporimit të legjislacionit gjithëpërfshirës kah fundi i vitit 2013, pas konsultimit publik ekstensiv dhe këshillimit me organizatat internacionale. Ekziston kontroll indirekt qeveritar mbi mediat përmes transmetimit të reklamave qeveritare nga mediat pro-qeveritare.

⁵Nuk është veçuar në këtë pjesë të Raportit.

Kriteri/ Nënkriteri/ Kapitulli	2011	2012	2013	2014
Të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore	Janë vendosur të drejta ekonomike dhe sociale, progres i caktuar i mëtutjeshëm	Progres i caktuar	⁶	Progres i caktuar
Mbrojtja nga diskriminimi			Nuk ka progres	<p>Sa u përket të drejtave të komunitetit LGBT, nevojiten përpjekje të konsiderueshme për ngritjen e vetëdijes për respektimin e diversiteteve në shoqëri dhe shmangien e mostolerancës, e cila përhapet përmes rrjeteve sociale.</p> <p>Kryerësit e incidenteve akoma nuk ndiqen. Të dhënat, sa i përket njoftimit, hetimit dhe ndjekjes së gjuhës së urrejtjes dhe veprave të urrejtjes, nuk grumbullohen sistematikisht.</p> <p>Nevojitet harmonizimi me Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi me acquis të BE , meqë në Ligj nuk është inkorporuar orientimi seksual si bazë për diskriminim, si dhe trajnimi i prokurorëve publikë dhe gjyqtarëve.</p>
Të drejtat minoritare, mbrojtja e minoriteteve dhe të drejtat kulturore	Progres i caktuar	Progres i caktuar	Mungesa e resurseve financiare, bashkëpunimi jopërkatës midis institucioneve, si dhe nevoja për implementimin proaktiv të politikave relevante (p.sh. Strategjia e Romëve) e kufizojnë progresin në aspekt të respektimit dhe mbrojtjes së minoriteteve.	<p>Progresi në mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve edhe më tutje pengohet për shkak të financave të pamjaftueshme dhe resurseve njerëzore, si dhe për shkak të bashkëpunimit joadekuat midis organeve kompetente.</p> <p>Nevojitet qasje proaktive që të</p>

⁶Nuk është veçuar në këtë pjesë të Raportit.

Kriteri/ Nënkriteri/ Kapitulli	2011		2012		2013	2014
						garantohet identiteti etnik, kulturor dhe gjuhës të të gjitha bashkësive.
Implementimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit	Progres i caktuar	2	⁷		Marrëveshja është në fuqi nga viti 2001, megjithatë, nevojitet akoma progres në lidhje me çështjet sistemore që kanë të bëjnë me decentralizimin, mosdiskriminimin, përfaqësimin e drejtë, përdorimin e gjuhëve dhe arsimin.	Konstatohet se “dominon mungesa e besimit midis bashkësive”, si dhe se “ngjarjet dhe incidentet lehtësisht shkaktojnë tensione”. Qeverisë i rekomandohet të ketë qasje më proaktive dhe të përbashkët në promovimin e shoqërisë multietnike inkluzive. Vihet në pah nevoja që të kompletohet analiza e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, si dhe të jepen rekomandime.

⁷Nuk është veçuar në këtë pjesë të Raportit.

Kriteri/ Nënkriteri/ Kapitulli	2011	2012	2013	2014
I. 1.3. Çështjet rajonale dhe detyrmet ndërkombëtare	Partner konstruktiv në rajon, marrëdhënie bilaterale të avancuara, çështja e emrit vazhdon të ndikojë në marrëdhëniet me Greqinë	Në mënyrë aktive merr pjesë në bashkëpunimin rajonal dhe vazhdon me avancimin e marrëdhënieve bilaterale me fqinjët. Çështja e emrit vazhdon të ndikojë mbi marrëdhëniet me Greqinë; nevojitet sjellje konstruktive në qasjen ndaj fqinjëve	Në mënyrë aktive merr pjesë në bashkëpunimin rajonal dhe vazhdon me avancimin e marrëdhënieve bilaterale me fqinjët. Ruajtja e marrëdhënieve të mira fqinjësore, përfshirë edhe zgjidhjen e çështjes së emrit, mbetet çështje kryesore. Ka çështje të hapura në negociatat për marrëveshje bilaterale me Bullgarinë. Nevojitet qasje konstruktive në marrëdhëniet me fqinjët dhe duhet të shmangen aksione dhe deklarata të cilat mund të kenë ndikim negativ.	Në mënyrë aktive merr pjesë në bashkëpunimin rajonal dhe vazhdon me avancimin e marrëdhënieve bilaterale me fqinjët. Ruajtja e marrëdhënieve të mira fqinjësore, përfshirë edhe zgjidhjen e çështjes së emrit mbetet çështje kryesore. Ka çështje të hapura në negociatat për marrëveshje bilaterale me Bullgarinë.
Vlerësim i përgjithshëm	Në masë të mjaftueshme vazhdon t'i përmbush kriteret politike	Në masë të mjaftueshme vazhdon t'i përmbush kriteret politike	Në masë të mjaftueshme vazhdon t'i përmbush kriteret politike	Në përgjithësi, duke pasur parasysh progresin kumulativ që ka arritur vendi, Komisioni konsideron se kriteret politike vazhdojnë të plotësohen në mënyrë të mjaftueshme dhe mban rekomandimin për të hapur negociatat e aderimit, por shpreh keqardhje për ngecjet e vitit të kaluar.

Pasqyra e konkluzioneve dhe vlerësimeve lidhur me kriteret ekonomike 2013-2014

	2013	2014
<i>2.1. Ekzistimi i ekonomisë funksionale të tregut</i>		
<i>Politika ekonomike</i>	Është ruajtur konsensus i gjerë për politikat themelore ekonomike.	Është ruajtur konsensus politik për bazat e ekonomisë së tregut, megjithatë politika ekonomike dhe menaxhimi me konsumin publik më shumë janë udhëhequr nga motivet ad hoc, në vend që të udhëhiqen nga nevojat afatgjate të ekonomisë.
<i>Stabiliteti makroekonomik</i>	Rritja e ripërtërirë e ekonomisë mbetet ngushtë e lidhur me investimet, me përf forcimin gradual të sektorit të jashtëm, si dhe me mbështetje marginale nga konsumi privat.	Rritja e prodhimtarisë duhet të ketë bazë më të gjerë, ndërsa deficit i jashtëm është e mundur përsëri të rritet përkohësisht për shkak të importit investues.
<i>Tregu i fuqisë së punës</i>	Përveç disa përmirësimeve të veçanta të shifrave, në tregun zyrtar të punës, politika e tregut të punës pati sukses të kufizuar në zgjidhjen e çështjes së papunësisë së madhe. Sfidat strukturore të tregut të punës duhet të zgjidhen.	Reformat për ballafaqimin me rigiditetet strukturore të tregut të punës arritën vetëm progres të kufizuar. Punësimi i punëtorëve duhet të përmirësohet përmes masave strukturore, si dhe përmes targetimit më të mirë të masave aktive në tregun e punës.

	2013	2014
<i>Disiplina fiskale</i>	Menaxhimi fiskal dhe disiplina fiskale janë përkeqësuar dhe do të ishte i dobishëm zbatimi i strategjisë afatmesme. Miksi i politikave pjesërisht është përkeqësuar. Edhe pse politika monetare siguroi mbështetje kyç për stabilitetin makroekonomik, disiplina fiskale u dobësua dhe borxhi edhe më tutje shënon rritje. Financat publike mund të kontribuojnë në drejtim të stabilitetit më të madh, për shembull, përmes subordinimit më të mirë të prioritetëve të konsumit lidhur me sfidat strukturore, me fokus të veçantë mbi rritjen e konsumit publik. Përveç kësaj, rritja e shpejtë e borxhit të financuar kryesisht nga jashtë, e rrit vulnerabilitetin e shtetit.	Disiplina fiskale duhet të përmirësohet, ndërkohë që ekziston hapësirë e konsiderueshme për përmirësimin e transparencës fiskale. Planet qeveritare për konsolidimin fiskal duhet të mbështeten me masa konkrete.
<i>Veprimi i ndërsjellë i fuqive të tregut</i>	Ekonomia kryesisht menaxhohet nga ana e sektorit privat me rol të kufizuar të shtetit, edhe pse pjesëmarrja e pronësisë publike është rritur në mënyrë të pakonsiderueshme.	Pjesëmarrja e shtetit në ekonomi dhe përcaktimi i çmimeve mbetet prudent.
<i>Hyrje dhe dalje nga tregu</i>	Përderisa regjistrimi dhe puna e sektorit afarist janë lehtësuar në mënyrë shtesë, dobësitë gjatë falimentimit dhe procedurat e likuidimit edhe më tej mbeten pengesë e konsiderueshme për investime dhe akses deri në financa.	Përderisa fillimi i biznesit bëhet pak më i lehtë, mbeten vështirësitë gjatë fitimit të lejeve. Dalja nga tregu mbetet e gjatë edhe pse Qeveria ka ndërmarrë hapa reformuese në drejtim të mirëfilltë.

	2013	2014
<i>Sistemi juridik</i>	Sistemi juridik, sa i përket ekonomisë funksionale të tregut, në masë të madhe është vendosur, por mbeten dobësitë lidhur me procedurat e gjata, zbatimin e kontratave dhe korrupsioni.	Sistemi juridik, sa i përket ekonomisë funksionale të tregut, në masë të madhe është vendosur, por në praktikë rritet joefikasiteti përmes procedurave të gjata të cilat e pengojnë zbatimin e ligjeve. Ndryshimet e shpeshta të ligjeve krijojnë pasiguri juridike.
<i>Zhvillimi i sektorit financiar</i>	Sektori financiar mbetet i kapitalizuar mirë dhe likuid. Megjithatë, rritja kreditore është e ngadalshme dhe kreditë jofunksionale paraqesin sfida të madhe.	Sistemi financiar mbetet stabil, ndërsa kapacitetet mbikëqyrëse janë përforcuar. Prapë se prapë aksesit deri te financat mbetet i vështirë dhe segmentet jobankare të tregut duhet edhe më tutje të zhvillohen me qëllim që të zgjerohen mundësitë e financimit të sektorit privat. Duhet të vazhdohet me ndërmarrjen e masave përmes së cilave do të përmirësohet kanali i borxheve bankare, përfshirë edhe pastrimin e portofolave jofunksionale kreditore.
<i>Ballafaqimi me presionet e konkurrencës së BE</i>		



	2013	2014
<i>Alokimi i kapitalit njerëzor dhe fizik</i>	Ekziston progres gradual në zgjidhjen e nevojave reformiste në sistemin ekonomik. Kapitali mbetet modest, ndërsa konsumi publik fokusohet në masë të pamjaftueshme mbi aktivitetet për zmadhimin e rritjes.	Qeveria ka arritur progres të caktuar lidhur me zgjidhjen e mangësive kryesore në alokimin e kapitalit njerëzor dhe fizik në vend, megjithatë sfidat e investimeve, të cilat janë të nevojshme për përshtetimin e rritjes së produktivitetit të punës dhe transformimit strukturor të ekonomisë mbeten të mëdha. Qeveria duhet të vazhdojë ta përmirësojë përbërjen e shpenzimeve përmes projekteve prioritare investuese, në përputhje me potencialin e tyre për produktivitet në bazë të vlerësimit të shpenzimeve.
<i>Struktura sektoriale e ndërmarrjeve</i>	Është i dukshëm diversifikimi gradual i prodhimit ekonomik sa i përket vlerës së shtuar dhe eksportit.	Strukturat sektoriale e ndërmarrjeve në ekonomi janë në stagnim dhe janë të fokusuar në aktivitete me produktivitet të ulët. Rritja e paradokshme e numrit të kompanive të mëdha tregon se pjesëmarrja e aktiviteteve prodhuese të avancuara mund të përforcohet në vitet e ardhshëm, por transformimi i mirëfilltë sektorial mbetet i paarrtshëm.
<i>Ndikimi i shteti mbi konkurrencën</i>	Edhe pse ligjet për ndihmë shtetërore janë përforcuar, ekziston mungesë e transparencës në lidhje me detajet e implementimit dhe shumat, për shkak të mangësive gjatë informimit.	Përkundrajt pjesëmarrjes së ulët të shtetit në ekonomi, legjislacioni i përmirësuar për ndihmë shtetërore dhe derregullimi i mëtutjeshëm i tregut të energjisë elektrike, ndikimi i shtetit mbi konkurrencën përmes implementimit të instrumenteve të tjerë të politikës, me sa duket shënon rritje.

	2013	2014
<i>Integrimi tregtar në BE</i>	Integrimi tregtar në BE është avancuar në masë të konsiderueshme. Struktura e eksportit vazhdon të përmirësohet, edhe pse produktet përpunuese tradicionale akoma dominojnë. Konkurrenca ndërkombëtare e çmimeve, në masë të madhe, mbetet e pandryshuar.	Lidhjet tregtare me BE në vitin 2013 shënuan rritje, edhe sa i përket eksportit edhe sa i përket importit, ndërsa BE mbetet me pjesëmarrje më të madhe në investimet e drejtpërdrejta të huaja.

Pasqyra e konkluzioneve dhe vlerësimeve lidhur me përmbushjen e detyrimeve nga anëtarësimi 2009-2014

Kapitulli	Progresi						Niveli i harmonizimit					
	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2009	2010	2011	2012	2013	2014
1. Qarkullimi i Lirë i Mallrave	2	4	2	4	2	2	2	3	3	4	4	4
2. Lëvizja e Lirë e Punëtorëve	2	1	1	2	2	2	1	1	1	1	1	1
3. E Drejta e Themelimit dhe Liria e Sigurimit të Shërbimeve	2	2	3	2	2	1	1	2	1	3	3	3
4. Qarkullimi i Lirë i Kapitalit	2	3	2	2	1	1	2	2	3	3	3	3
5. Prokurime Publike	4	3	3	2	4	3	4	3	5	4	4	4
6. E drejta e Shoqërive Tregtare	4	4	4	4	4	4	3	3	3	3	4	4
7. E drejta e Pronës Intelektuale	2	2	2	2	2	2	4	3	3	3	3	3
8. Politika e Konkurrencës	2	2	2	4	4	4	4	3	3	4	4	4
9. Shërbime Financiare	2	4	4	3	3	2	3	3	3	3	3	3
10. Shoqëria Informatike dhe Mediat	3	3	3	3	3	4	4	3	3	3	3	3
11. Bujqësia dhe Zhvillimi Rural	3	3	3	3	2	2	1	2	3	3	3	3
12. Siguria e Ushqimit, Politika Veterinare dhe Fitosanitare	2	2	4	4	4	3	2	2	4	3	3	3
13. Peshkimi	2	2	2	2	1	1	2	2	3	3	3	4
14. Politika e Komunikacionit	4	2	3	1	2	2	4	4	4	3	3	3
15. Energjia	2	2	4	2	2	2	2	3	3	3	3	3
16. Tatimimi	4	1	1	2	2	2	3	3	3	3	3	3
17. Politika Ekonomike dhe Monetare	2	1	5	1	1	1	3	2	4	4	4	4
18. Statistika	4	4	4	3	4	4	4	4	4	3	4	4
19. Politika Sociale dhe Punësimi	1	1	1	1	2	1	3	1	2	2	1	3
20. Ndërmarrjet dhe Politika Industriale	3	2	3	2	2	2	3	3	3	3	3	3
21. Rrjete trans-europiane	3	2	3	3	2	2	4	3	4	3	4	4
22. Politika Rajonale dhe Koordinimi i Instrumenteve Strukturore	2	2	2	2	1	1	3	3	3	3	2	2
23. Jurisprudenca dhe të Drejtat Fundamentale	3	1	1	2	2	2	3	3	3	3	3	4

Kapitulli	Progresi						Niveli i harmonizimit					
24. Drejtësia, Liria dhe Siguria	4	3	3	3	3	3	4	4	4	4	4	4
25. Shkenca dhe Hulumtimi	2	2	3	2	4	4	4	3	2	2	2	3
26. Arsimi dhe Kultura	2	2	2	2	2	2	4	3	3	3	3	3
27. Mjedisi Jetësor	3	3	2	1	1	2	3	3	3	3	3	3
28. Mbrojtja e Konsumatorëve dhe Mbrojtja Shëndetësore	2	2	2	2	2	2	3	2	3	3	3	3
29. Unioni Doganor	5	2	4	3	2	3	4,5	4,5	4	4	4	4
30. Marrëdhëniet me Jashtë	2	3	3	2	1	1	4	4	4	3	3	3
31. Politika e Jashtme, e Sigurisë dhe Mbrojtjes	2	4	4	4	5	1	4	5	5	5	5	3
32. Kontrolli Financiar	2	2	1	2	2	2	2	2	2	1	1	3
33. Dispozita Financiare dhe Buxhetore	2	2	1	1	0	1	3	3	3	1	1	1



Shënim: Instituti përdor metodologji të vet, me ç'rast në pasqyrimin e vlerësimit të përgjithshëm, vlera e kapitujve të veçantë është ponderuar duke e pasur parasysh vëllimin dhe rëndësinë e tyre.

Shpjegime për kuantifikimin e vlerësimeve sa i përket progresit dhe harmonizimit

Progresi

<i>Vlerësimi</i>	Vlera numerike
Regres	(-5)-(-1)
Nuk ka progres; nuk ka progres të mëtutjeshëm	0
Nuk ka progres thelbësor; nuk ka progres të veçantë; progres i pakënaqshëm; progres i ngadaltë; progres fillestar, progres i kufizuar	1
Progres i vogël; progres modest, progres i caktuar	2
Progres; progres i mëtutjeshëm	3
Progres i mirë; progres evident; progres i qëndrueshëm; progres i kënaqshëm	4
Progres i konsiderueshëm; progres i rëndësishëm; progres thelbësor	5

Niveli i harmonizimit:

<i>Vlerësimi</i>	Vlera numerike
Nuk ka filluar	0
Faza e hershme; faza shumë e hershme; faza fillestare	1
Nuk ka shënuar progres të madh; shënon progres; progres i ngadalshëm	2
Progres mesatar	3
Progres i avancuar, në fazë të avancuar	4
Progres i mirë	5